



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DELVINË  
KESHILLI

Nr. 1478 Prot.

Date 26/06/2018

**V E N D I M**

**Nr. 31, date 20.06.2018**

**“Per miratimin e planit vendor te veprimit kunder zhurmave ne mjediset publike”**

Ne zbatim te Ligjit nr 139/2015 date 17.12.2015 “Per Vetqeverisjen Vendore” neni 54, pika ‘k’ , Ligji nr 9774 date 12.07.2007 “Per Vleresimin dhe Administrimin e Zhurmes ne Mjedis” , Neni 8 dhe Neni 20 , me propozim te Sektorit te Policise Bashkiake te Bashkise Delvine, Keshilli i Bashkise Delvine, me 9 (nente) vota pro, 3 (tre) abstenim dhe asnje kunder;

**V E N D O S I**

1. Te miratoje planin vendor te veprimit kunder zhurmave ne mjediset publike , sipas lidhjes bashkalidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Policise Bashkiake per zbatimin e ketij vendimi.
3. Ky vendim hyn ne fuqi pas shprehjes se ligjshmerise nga Prefekti i Qarkut Vlore.

**KRYETARE**

**Alba HUDA**



## PLANI VENDOR I VEPRIMIT KUNDER ZHURMAVE NE MJEDISËT PUBLIKE

Ne zbatim të Ligjit nr 9774 date 12.07.2007 "Per Vleresimin dhe Administrimin e Zhurmes ne Mjedis", si dhe udhezimeve ne funksion te tij hartohet ky plan vendor veprimi kunder zhurmave ne mjediset publike.

- Moslejimin e subjekteve te cilet ushtrojne aktivitet ne qendrat e banuara te ndodhura ne territorin e Bashkise Delvine te cilet shkaktojne zhurma mbi normat e lejuara te percaktuara ne aktet ligjore.
- Ushtrimin e kontroleve te perbashketa me institucionet e tjera te subjekteve dhe paisjen e tyre me leje mjedisore per zhurmat e shkaktuara gjate aktivitetit te tyre nga organet e ngarkuara.
- Oraret e ushtrimit te aktivitetit per subjektet te cilet shkaktojne zhurma ne mjedis publik ( si muzike etj) te jene per periudhen Maj-Tetor prej ores 6.00 deri ne oren 24.00 dhe per periudhen Nentor-Prill prej ores 6;00 deri 22;00.
- Per raste te vecanta si festa,aktivtete kulturore,sportive,ose subjektet qe zhvillojne ceremoni dasmash duhet te pajisen me leje te posacme nga institucioni i bashkise per te zhvilluar veprimtarine e tyre jashte orarit te percaktuar.
- Ne bashkepunim me organet e inspektoriatit te mjedisit si dhe ato te rendit te kryhet marrja e masave ndeshkuese per kundravajtjet administrative ndaj subjektet te cilat shkelin dispozitat e parashikuara ne ligjin e cituar me siper.

